



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

MEMORANDUM SHPJEGUES

PËR

RREGULORE NR. X/2023

PËR STATUSIN, KUSHTET DHE PROCEDURËN E EMËRIMIT TË PANELIT ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

1. Qëllimi i hartimit të aktit normative

Kjo rregullore synon të përcaktojë statusin, kushtet, procedurën e përzgjedhjes dhe emërimin e anëtarëve të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (tutje: PZAP).

Për të arritur qëllimin e saj rregullorja vendos parimet në bazë të të cilave Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ushtron fushëveprimtarinë e tij. Këtu përfshihen edhe kushtet dhe përvoja specifike për përzgjedhjen e anëtarëve të PZAP dhe mënyra se si ata janë të mbrojtur nga përgjegjësia penale dhe civile.

Për sa i përket afatit të emërimit të kryesuesit dhe anëtarëve të PZAP,

	<p>rregullorja përcakton një kohë të caktuar në të cilën ata duhet të jenë emëruar nëse pozitat e tyre mbeten të lira. Gjithashtu, ajo rregullon procedurat për shpalljen e pozitës së lirë, mënyrën e aplikimit, dhe komisionet përgjegjëse për shqyrtimin e aplikacioneve dhe ankesave, si dhe të drejtën e ankesës së kandidatëve si palë të pakënaqura në rast se konsiderojnë se i kanë plotësuar kushtet formale për emërim si anëtar i PZAP të parapara me rregullore dhe nuk janë emëruar.</p> <p>Përveç procedurave të emërimit, rregullorja përcakton gjithashtu mënyrën e suspendimit, shkarkimit dhe përfundimit të mandatit të anëtarëve të PZAP.</p>
<p>2. Arsyetimi i aktit normative</p>	<p>Arsyeja e hartimit të Rregullore Nr. X/2023 për Statusin, Kushtet dhe Procedurën e Emërimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës është për shkak të ndryshimeve ligjore. Me shfuqizimin e Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës dhe hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ka ndryshuar përbërja, emërtimi dhe mënyra e emërimit të Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës.</p>

	<p>Risi me këtë projekt rregullore është se Këshilli Gjyqësor i Kosovës emëron kryesuesin e PZAP-së, nga radha e gjykatësve të Gjykatës Supreme, ndërsa anëtarët nga radha e gjykatësve të Gjykatës së Apelit, për dallim nga ligjit i cili ka qene në fuqi, sipas të cilit emërimi i Komisionit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës ka qene e drejtë ekskluzive e Kryetarit të Gjykatës Supreme.</p> <p>Kjo rregullore është e nevojshme për arsyet si ne vijim:</p> <p>Së pari rregullorja ka për qëllim të përcaktojë procedurën e emërimit që nga shpallja e pozitës së lirë deri tek suspendimi, shkarkimi dhe përfundimi i mandatit të anëtarit të PZAP.</p> <p>Së dyti synohet që përmes procedurës së emërimit të kryesuesit/ anëtarëve të PZAP të behet funksionalizimi i këtij organi.</p>
<p>3. Kohëzgjatja e konsultimit publik</p>	<p>Përmes procesit të konsultimeve me publikun, synohet transparenca dhe ofrohet mundësia e pjesëmarrjes së publikut dhe palëve të interesuara në procesin e hartimit të draftit të Rregullore Nr. X/2023 për Statusin, Kushtet dhe Procedurën e Emërimit</p>

	<p>të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia.</p> <p>Këshilli fton të gjithë profesionistët e interesuar që të paraqesin komentet apo sugjerimet e tyre, për përmirësimin e draftit të kësaj rregullore.</p> <p>Kohëzgjatja e konsultimit publik është pesëmbëdhjetë (15) ditë kalendarike, përkatësisht deri me 27 tetor 2023.</p>
4. Informatat në lidhje me personin kontaktues për konsultim publik	<p>Të gjithë pjesëmarrësit e publikut dhe palët e interesuara mund t'i japin komentet dhe sugjerimet e tyre brenda afatit të përcaktuar për konsultim publik për këtë draft të rregullore, përmes postës elektronike në këtë e-mail adresë: kgjk@rks-gov.net</p>